



European
Union
Kosovo

STRATEGJIA DHE
PLANI I VEPRIMIT PËR
KOMUNËN MIKE PËR FËMIJË
(XXXX - XXXX)





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA E KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E _____
OPŠTINA _____
MUNICIPALITY OF _____

**STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT
PËR
KOMUNËN MIKE PËR FËMIJË
(XXXX – XXXX)**

Ky publikim është mundësuar në kuadër të projektit “Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë”, projekt i financuar nga Bashkimi Evropian, i udhëhequr nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijës KOMF.

Përmbajtja dhe pikëpamjet e publikimit “Strategjia Komunale dhe Plani i Veprimit për realizimin e të drejtave të fëmijëve” janë përgjegjësi e vetme e Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian.

Ky model bazohet në Rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësor për fëmijët e cila është miratuar nga Komuna e Gjakovës në kuadër të projektit “Gjakova komunë mike për fëmijët” dhe është përkrahur nga Zyra e UNICEF-it në Kosovë.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (Kosovë) është koalicioni i përbërë nga 27 OJQ lokale dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, me mision të përbashkët avokimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Koalicioni punon në promovimin e mbrojtjes, respektimit, mirëqenies dhe avancimit të të drejtave të fëmijëve, duke evokuar tek institucionet me influencë për të promovuar dhe zhvilluar të drejtat e fëmijëve në pajtim me KDF.

www.komfkosova.org/

Organizatat anëtare të Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë janë:

Asociacioni për Trajnime Sociale Hulumtime dhe Avokim – ASTRA • Aksioni për Nëna dhe Fëmijë • Balkan Sunflowers Kosova • Childproof – CIPOF • Education Comes First • Iniciativa 6 • Kosovo Education for Sustainable Development • HANDIKOS • Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës QKRMT • Organizata Rinore Akti • Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror • One To One Kosova – Qendra e Këshillimit për Familje • One to One Children’s Fund • OPFAKKOS • Programi për të Drejtat Civile – CRP/K • PL4Y International • Qendra për Edukim e Kosovës – KEC • Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me qenie njerëzore – MVPT • Qendra për Studime të Avancuara – FIT • Save the Children • SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë • Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF • Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK • Terre des hommes • The Ideas Partnership • VoRAE dhe WorldVision.

HYRJJE

Modeli i ofruar i “Strategjisë Komunale dhe Planit të Veprimit për realizimin e të drejtave të fëmijëve” është realizuar si përmbyllje e një procesi një vjeçar gjatë të cilit KOMF përmes ofrimit të shtatë nën financimeve për OJQ-të në shtatë komuna, ka mbështetur procesin e hartimit të Rregullores komunale për të Drejtat e Fëmijëve si dhe Strategjisë e Planit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve, në komunat: Prishtinë, Drenas, Fushë Kosovë, Lipjan, Gjilan, Ferizaj dhe Pejë.

KOMF falënderon shtatë kryetarët e komunave dhe stafet përkatëse për gjithë mbështetjen dhe angazhimin e ofruar gjatë procesit, organizatat jo qeveritare që kanë udhëhequr proceset respektive për hartimin e dokumenteve të lartpërmendur, përfaqësuesit nga komunat dhe OJQ-të, si dhe ekspertët lokal të angazhuar për grumbullimin e të dhënave, analizën dhe përpilimin e Rregullos Komonale si dhe Strategjisë e Planit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve.

Ky model ofrohet për të mundësuar rritjen e vëmendjes dhe angazhimit nga ana e komunave me qëllim që çështjet të cilat kanë të bëjnë dhe ndërlidhen me fëmijë, të vihen në qendër dhe të kthehen në prioritet të axhendës së qeverisjes komunale. Ky dokument ofron mundësinë për secilën komunë, që të përfshihet të trajtojë çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët, duke synuar kështu realizimin e të gjitha të drejtave të tyre.

Kjo Strategji dhe Plan Veprimi në vetvete përbëjnë përgjegjshmërinë dhe angazhimin praktik të një komune mike për fëmijët e saj, e cila synon vendimmarrjen, llogaridhënien dhe angazhimin praktik drejt realizimit të të drejtave, përmbushjes së potencialit të plotë të fëmijëve, si një mundësi më shumë që fëmijët të rriten të sigurtë, të shëndetshëm e të lumtur në ambientet, mjediset dhe komunitetet ku ata zhvillojnë ekzistencën e tyre.

Modeli i Strategjisë Komunale dhe Planit të Veprimit, u ofrohet si model referues të gjitha komunave të Kosovës, duke u ofruar atyre një mundësi të replikimit të procesit dhe hartimit të Rregullos Komonale dhe Strategjisë e Planit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve, brenda komunave të tyre.

PËRMBAJTJA

Hyrje	5
Mbrojtja e të drejtave të Fëmijëve në kontekstin global, nacional e lokal.....	6
Parimet, vlerat, vizioni dhe misioni	7
Objektivat strategjike	9
Plani i veprimit	18

HYRJJE

_____ mik për fëmijë është një thirrje për veprim dhe përkushtim për të përfshirë çështjet e fëmijëve në agjendën e politikave të qeverisjes lokale. Kjo thirrje promovon gjithë përfshirjen dhe llogaridhënien për jetësimin e të drejtave të fëmijëve në mënyrë progresive. Kjo qasje promovon vizionin për fëmijët e _____ që të zhvillohen, të mësojnë e të rriten në një ambient dhe komunitet të qëndrueshëm, ku praktikohet qeverisja e mirë duke i vendosur fëmijët në agjendën zhvillimore dhe duke u ofruar mundësinë djemve dhe vajzave që të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes.

Për të jetësuar konceptin e komunës mike për fëmijë, Komuna e _____ parasheh të ketë një koncept që siguron zbatimin e politikave dhe praktikave për fëmijë ku përfitojnë të gjithë fëmijët. Zbatimi i këtyre politikave fuqizohet dhe monitorohet në vazhdimësi. Vëmendje e veçantë i kushtohet alokimit të buxhetit për fëmijë, ndërmarrjes së një varg masash për shpërndarjen e burimeve të veçanta financiare për fëmijët, si dhe rritjes së transparencës në vendimmarrje dhe administrim të burimeve të tilla. Mbledhja e rregullt e të dhënave për gjendjen e fëmijëve të komunës, si një parakusht për planifikim, do të informojë vendimet për vendosjen e prioriteteve dhe do të ofrojë një bazë për debat politik dhe social lidhur me gjendjen e popullatës së re të komunës dhe të gjeneratës së ardhshme.

Kjo strategji është pjesë e një procesi të gjatë dhe dinamik që ka ndodhur në nivel komune. Ky proces ka përfshirë sektorët e ndryshëm komunal, institucionet e nivelit qendror që ofrojnë shërbime për fëmijë në nivel komunal, organizatat e shoqërisë civile, si dhe organizatat e institucionet e pavarura. Një grup punues me përbërje të ndryshme, ku janë përfaqësuar të gjitha palët ka qenë pjesë aktive e procesit gjatë gjithë kohës.

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË KONTEKSTIN GLOBAL, NACIONAL E LOKAL

Konventa për të Drejtat e Fëmijës paraqet themelet e secilit veprim në fushën e të drejtave të fëmijës. Parimet e saj janë të përqafuara në politika ndërkombëtare që prekin jetën e fëmijëve, por edhe në politikat vendore e lokale.

Komuniteti ndërkombëtar në vitin 2000 lansoi Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit, një nismë e liderëve botërorë e përbërë prej 8 objektivave që nisin me zhdukjen e varfërisë dhe urisë, e përfundojnë me partneritetin ndërkombëtar për zhvillim, të gjitha më qëllim të përmirësimit të jetesës së më të varfërve.

Me përfundimin e periudhës së Objektivate Zhvillimore të Mijëvjeçarit më 2015, viti 2016 ishte viti kur liderët botërorë në Kombet e Bashkuara zyrtarisht lansuan Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm. Kjo agjendë promovon 17 objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm për ta transformuar botën deri më 2030¹. Për t'u arritur këto objektiva secili duhet të bëjë pjesën e vet të punës: qeveritë, sektori privat, shoqëria civile dhe të gjithë qytetarët. Kjo strategji është një kontribut në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, e përshtatur për kontekstin lokal. Aq më parë, kur fëmijët janë në fokusin më të madh të këtyre objektivave, e në fokus ekskluziv të kësaj strategjie. Në seksionet më poshtë, paraqiten në mënyrë figurative lidhjet në mes objektivave të kësaj strategjie dhe objektivave të caktuara të zhvillimit të qëndrueshëm, për të parë më qartë kontributin në përmbushjen e kësaj politike globale për përmirësimin e jetës së njerëzve.

Kuvendi i Republikës së Kosovës me dt: 25 Janar 2018 ka miratuar rezolutën Nr 06-R-001 Për Miratimin e Objektivate për Zhvillim të Qëndrueshëm (ose agjendën 2030) bazuar në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme A/RES/70/1 të miratuar nga 193 lider nga mbar bota më 25 shtator 2015 dhe të lidhura me Deklaratën e Konferencës Botërore të Kryetarëve të Parlamenteve si pikat kryesore të references si pika kryesore mbi të gjitha politikat për zhvillim të qëndrueshëm.²

Në Kosovë, tashmë disa vite e kemi projekt-ligjin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në proces. Ky projekt-ligj e ndjek frymën e Konventës për të drejtat e fëmijës, si dhe tregon rolin e institucioneve në mbrojtjen e fëmijëve, krijimin e mekanizmave dhe masat e veçanta mbrojtëse. Ku besuar se ky ligj, posa të marrë miratimin final do të avancojë edhe më tutje realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre në përgjithësi në Kosovë. Derisa, Komuna e _____ ka bërë një hap tutje duke ndërmarrë nismën për të nxjerrë politika lokale që rregullojnë këtë fushë të rëndësishme për shoqërinë. Tashmë Rregullorja për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve përmes Sistemit Qeverisës Komunal Miqësor Për Fëmijët, ka marrë miratimin në Kuvend. Vazhdimësi e frymës së kësaj rregulloreje është nxjerrja kësaj Strategjie dhe Plani të Veprimit që mundëson një sistem të integruar komunal për avancimin e të drejtave të fëmijëve në Komunën tonë. Gjithë këtë proces e kemi zhvilluar në partneritet më shoqërinë civile, përkatësisht kontribut të çmuar kanë dhënë _____.

¹ www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/

² http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/2018_01_30_Rezoluta_06_R_001.pdf

PARIMET

Komuna e _____ në punën e vet mëton të promovojë modelin e qeverisjes lokale me të cilën është në shërbim të të gjithë qytetarëve të saj, me theks të veçantë në mbrojtje të të drejtave të Fëmijëve. Ky model qeverisës promovon parimet kryesore që janë dhe mbeten si një pjesë shumë e rëndësishme në Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve të cilat derivojnë nga Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës të cilat janë:

- **Mos diskriminimi** - të gjithë fëmijët duhet t'i gëzojnë të gjitha të drejtat. Asnjë fëmijë nuk duhet të trajtohet padrejtësisht mbi asnjë bazë.
- **Interesat më të larta të fëmijës** - kur merren vendime që ndikojnë në fëmijët, interesave më të larta të fëmijës duhet t'u jepet vëmendje parësore.
- **Jeta, mbijetesa dhe zhvillimi** – të gjithë fëmijëve duhet t'u sigurohet mbijetesa dhe zhvillimi deri në masën më të madhe të mundshme. Zhvillimi përfshin edhe dimensionin e cilësisë: jo vetëm shëndeti fizik, por edhe zhvillimi mendor, emocional, kognitiv, social dhe kulturor.
- **Pikëpamjet e fëmijës** - fëmijët duhet të jenë të lirë të shfaqin pikëpamjet lidhur me çdo çështje që ndikon në ta dhe këtyre pikëpamjeve duhet t'u jepet peshë e duhur në përputhshmëri me moshën dhe pjekurinë e fëmijëve.

VLERAT

Komuna e _____ përmes sistemit të saj qeverisës, duke u mbështetur në politikat e saj si dhe me mbështetje të partnerëve të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtare duhet të promovojë vlerat e saj qeverisëse si një komunë mike për fëmijë përmes Qeverisjes komunale të mirëfillte. Këto vlera duhet promovojnë që fëmijët të:

- Dëgjohen dhe përfshihen në vendimmarrjen lokale;
- Kenë ndikim në hartim të politikave lokale;
- Janë të mbrojtur nga të gjitha llojet e abuzimit dhe keqpërdorimit;
- Krijon hapësira dhe mjedise të favorshme për fëmijët;
- Përfshinë fëmijët në aktivitete të ndryshme kulturore-artistike dhe rekreative-sportive.

VIZIONI

_____ qytet mik për fëmijë, ku fëmijët janë pjesë e hartimit të politikave lokale përmes së cilave promovohen parimet themelore të të drejtave të fëmijëve.

Komuna e _____ duhet të jetë e hapur në të gjitha aspektet e vendimmarrjes, duke u ofruar mundësi për zhvillim të fëmijëve e cila garantohet nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe legjisllacioni në fuqi. Duke u bazuar në këto dokumente me rëndësi Komuna duhet të jetë zë i fuqishëm i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve.

MISIONI

Komuna e _____ do të mundësojë gjithë përfshirje të fëmijëve në përmbushjen e të drejtave të tyre, duke ofruar mbështetje në realizimin dhe jetësimin e qëllimeve për një mirëqenie më të mirë për fëmijët.

Komuna e _____ merr përsipër apo zotohet që të ofroj një qeverisje lokale gjithëpërfshirëse ku interesat e fëmijëve do të zënë një vend të theksuar në qeverisjen lokale. Fëmijëve të Komunës së _____ duhet të iu ofrohen kushte të mira në sistemin e arsimit që premtion një të ardhme të ndritur, një sistem shëndetësor që kujdeset për shëndetin e tyre. Fëmijët janë zë i fuqishëm në të gjitha proceset vendimmarrëse që lidhet me jetën e tyre si dhe të përfshihen në të gjitha aktivitetet kulturore-artistike dhe sportive. Të gjitha këto veprime janë bazë për një qeverisje lokale gjithëpërfshirëse.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Janë pesë fusha në të cilat mbështetet ndërmarrja për krijimin e komunës mike për fëmijë. Këto fusha në asnjë mënyrë nuk mund të adresohen si të vetme. Përkundrazi ato janë të lidhura ngushtë në mes veti dhe e plotësojnë njëra-tjetrën.

Ofrimi i shërbimeve cilësore për të gjithë fëmijët e Komunës, me fokus të veçantë në kategoritë e fëmijëve në nevojë

Përmirësimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimarrëse në Komunë dhe aktivitete rekreative-sportive

Krijimi i sistemit efektiv të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve

Krijimi i hapësirave publike të sigurta dhe promovimi i mjedisit ekologjik

Bashkërendimi i veprimeve, raportimi i rregullt dhe vlerësimi i zbatimit të politikave për mbrojtjen e fëmijëve - Mekanizmi Koordinues

Këto fusha prioritare, të përkthyer në objektiva strategjike përmbajnë masa që përmbushin këto objektiva, por njëkohësisht ndërlidhen me objektiva tjera duke i plotësuar këto, dhe duke e bërë koherente ndërmarrjen strategjike.

Si shembull shumë masa të fushës së vetëdijesimit dhe avokimit për fëmijë në mënyrë të drejtpërdrejtë e përmirësojnë ofrimin e shërbimeve për fëmijë. Prandaj, kudo që masa e një fushe ka lidhje të dukshme edhe me ndonjë fushë tjetër, do të bëhet një referencë e tillë.

Një fushë tjetër, ndërkaq, që lidhet me aspekte të koordinimit, vlerësimit dhe raportimit, është konsideruar si transversale. Masat që përmban kjo fushë i lidhin të gjitha fushat dhe shërbejnë si një lloj bazamenti i gjithë ndërmarrjes.

1. Ofrimi i shërbimeve cilësore për të gjithë fëmijët e Komunës, me fokus të veçantë në kategoritë e fëmijeve në nevojë

Komuna e _____ dëri me tani nuk ka pasur një plan të veçantë në të cilin është marrur ekskluzivisht me kategoritë të fëmijëve në nevojë. Andaj, duam që si institucione komunale të përmirësojmë shërbimet e sektorëve si mirëqenie sociale, arsim, shëndetësi, kulturë, rini dhe sport. Kjo strategji parashikohet që të ketë ndikim më të shtuar tek fëmijët që kanë më shumë nevojë për përkrahje dhe mbështetje.

Të gjitha këta hapa janë parakusht për ofrimin e shërbimeve cilësore për të gjithë fëmijët e Komunës së _____ pa dallime, por do të jëtë përgjegjësi institucionale që ata të japin rol konstruktiv në këtë fushë. Komuna e _____ do të krijojë parakushtet themelore të cilat në praktik do të rrisin tërësinë e ofrimit të shërbimeve dhe kjo tërësi shërbimesh do luajë rol kyç për një jetë më të dinjitetshme.

1.1. Krijimi i një sistemi informues përmes zyrës për informim për tërësinë e shërbimeve për fëmijë në Komunë

Zyra për informim në Komunën e _____ do të krijojë një sistem të informimit për tërësinë e shërbimeve që ofronë për fëmijë. Në këtë format do të ofrohen informata mbi tërësinë e shërbimeve sociale, aktivitetet edukative arsimore si dhe informata të tjera të cilat janë në interes të fëmijëve.

1.2. Ofrimi i financimit emergjent për fëmijë

Krijimi i një financimi emergjent për fëmijë është një ndër hapat e parë që institucionet lokale duhet të ndërmarrin që të janë më pranë fëmijëve në nevojë. Andaj ofrimi i një financimi të përgjithshëm për fëmijë do të jetë njëri ndër hapat kryesorë që do të ndërmirret nga institucionet lokale.

1.3. Fuqizimi i konceptit të familjeve strehuese dhe farefisnore përmes subvencionimit nga Qendra për Punë Sociale

Familjet strehuese dhe farefisnore si koncept i ri, janë provuar të suksesshme, andaj Komuna e _____ do të organizojë fushata informuese për publikun për rolin e familjes strehuese dhe farefisnore, identifikimin dhe trajnimin e tyre përmes shkëmbimit të përvojave si dhe subvencionimin e tyre nga Qendra për Punë Sociale.

1.4. Përkrahje në ekzekutimin e masave të diversitetit, masave edukative dhe dënimeve për fëmijë që kanë rënë ndesh me ligjin

Institucionet komunale do të trajtojnë me kujdes të veçantë fëmijët të cilët kanë rënë ndesh me ligjin e të cilët janë në ekzekutim të masave të diversitetit, masave edukative apo dënimeve. Do të nënshkruhet një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Komunës, Shërbimit Sporvues dhe Shërbimit Korrektues për adresimi e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin, në ekzekutim të masave dhe dënimeve si dhe arsimimin e tyre.

1.5. Zhvillimi i praktikave të prindësisë së mirë dhe promovimi shëndetësor

Avancimi i politikave të prindësisë së mirë do të jetë një nga hapat e duhur në promovim dhe senzibilizim e një familje të shëndetëshme për gjithë fëmijët e Komunës së _____. Praktikave të tilla do të realizohen përmes fushatave të ndryshme senzibilizuese të cilat do të promovojnë dhe shërbejnë që fëmijët që nga lindja e dëri në pjekuri të kenë qasje të prindësisë së kujdesëshme.

1.6. Rritja e përfshirjes së fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në shërbimet/programet për edukim dhe zhvillim në fëmijëri të hershme

Do të krijohen kushte për rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor. Do të bëhet një vlerësim i nevojave komunale për edukim dhe zhvillim në fëmijëri të hershme. Mbi bazën e këtyre nevojave do të ftohet sektori privat për shprehje të interesit për partneritet me komunën në fushën e edukimit parashkollor. Lidhja e partneriteteve publiko-private në fushën e edukimit parashkollor do të mundësojë rritjen e përfshirjes së fëmijëve në programe të edukimit dhe zhvillimit në fëmijëri të hershme dhe do të mbajë këto shërbime afër komunitetit.

1.7. Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët për t'u regjistruar në shkollë, për ta vijuar dhe për përfunduar atë

Institucionet komunale me qëllim të gjithëpërfshirjes në shkollimin e obliguar do të adresojnë rastet e mosregjistrimit, mosvijimit të rregullt dhe braktisjes së shkollimit. Do të krijohet një sistem i komunikimit mes shkollave dhe zyrave të regjistrimit civil për t'i marrë të dhënat e fëmijëve të moshës shkollore nga zona që gravitojnë shkollat. Shkollat do të mirëmbajnë bazën e të dhënave me të dhëna për nxënësit sipas modelit të Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA). Do të funksionalizohen Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM), si dhe do të bashkëpunohet ngushtë me organizatat që punojnë në fushën e gjithëpërfshirjes në arsim.

1.8. Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër shkolla

Do të shtohen resurset njerëzore të DKA-së për ngritje të kapaciteteve, zhvillim profesional të mësimitdhënësve. Do të trajtohen mësimitdhënësit për identifikimin e hershëm të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale pedagogjike, psikologjike, sociale, shëndetit mendor dhe do të krijohet mekanizmi për referimin e fëmijëve për shërbime profesionale. Po ashtu, do të identifikohen nevojat për mësimitdhënësit mbështetës për fëmijët me nevoja të veçanta dhe do të bëhet përfshirja e fëmijëve në vendimmarrjen e shkollave.

1.9. Hartëzimi i hapësirave shkollore për sigurimin e arsimit cilësor

Cilësia e arsimit në një masë të madhe varet edhe nga gjendja e objekteve shkollore. Andaj, lidhur me këtë, do të krijohen ekipe profesionale për të bërë inspektimin e gjendjes së shkollave (inspektim të vjetërsisë së objekteve, sanitarisë, hapësirave për lojë e rekreacion, pajisjeve shkollore, etj). Këto ekipe do të inspektojnë objektet shkollore në baza vjetore dhe do të dalin me raporte vlerësuese për gjendjen e tyre. Mbi bazën e raporteve ndërmerren masa përmirësuese me qëllim të krijimit të objekteve dhe mjediseve shkollore të sigurta dhe miqësore për fëmijë, duke krijuar kabinete dhe laboratorë për shkenca ekzakte dhe teknologji informative(TIK).

1.10. Krijimi i mekanizmave brenda shkollave për mirëmbajtje të objekteve (mjediseve) shkollore

Manaxhmenti i shkollës duhet të angazhohet në ngritjen e vetëdijes së nxënësve për nevojën e mirëmbajtjes së objekteve shkollore. Do të hartohet një udhëzues me shembuj praktikë për mirëmbajtjen e hapësirave shkollore. Do të krijohen ekipe shkollore për koordinimin e veprimeve të mirëmbajtjes së hapësirave shkollore si dhe për çdo vit do të ndahet çmimi për komunitetin më të vjeshëm shkollor.

1.11. Organizimi i vizitave multidisiplinare shëndetësore dhe sociale të obligueshme për fëmijët, në baza periodike

Ofrimi i shërbimeve të individualizuara shëndetësore për secilin fëmijë varet shumë nga sigurimi i informatave për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve. Po ashtu do të zhvillohen kapacitetet e profesionistëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënës dhe fëmijës, këshillim për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël deri në moshën tre vjeçare dhe përkrahjen e zhvillimit në fëmijërinë e hershme. Do të hartohet udhërrëfyti për shërbimet e vizitave në shtëpi për grupet e varfëra dhe të marginalizuara sipas konceptit të ofrimit të shërbimeve sociale, të cilat do të kenë përveç komponentit të intervenimit shëndetësor edhe atë edukativ. Do të zbatohen praktikat efektive të kujdesit perinatal si dhe do të përfshihen të gjithë fëmijët në shërbimin e vaksinimit.

1.12. Identifikimi i hershëm lidhur me gjëndjen shëndetësore dhe emocionale të fëmijës

Me qëllim të identifikimit të hershëm lidhur me gjëndjen shëndetësore dhe emocionale të fëmijës, do të zhvillohet një dokument për deklarimin e prindit për gjëndjen shëndetësore të fëmijës, si parakusht për regjistrim në shkollë. Ky dokument i deklaratës së prindit do të shërbejë për të identifikuar fëmijët (sidomos fëmijët me nevoja të veçanta) për kontroll shëndetësor më të hollësishëm. Për ata fëmijë që dokumenti lexues pasqyronë gjëndjen që fëmija ka nevojë për një kujdes të shtuar, personeli shkollor do të ketë kujdes të veçantë ndaj tyre.

1.13. Ofrohen shërbime të veçanta për kategoritë e fëmijëve në nevojë

Komuna përmes QPS identifikon dhe krijon një databazë për fëmijët me nevoja të veçanta. Në bashkëpunim me institucionet e nivelit qendror, komuna ofron shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim i bazuar në bashkësi për këta fëmijë. Në hapësira publike sigurohet qasja fizike e fëmijëve me nevoja të veçanta, sigurohet një qendër ditore për ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse për fëmijët në nevojë, ofrohen programe të mbështetjes shtesë për fëmijët në nevojë/grupeve të marginalizuara. Po ashtu do të organizohen fushata shumëdimensionale për parandalimin e punëve të rënda për fëmijë.

2. Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse në Komunë dhe aktivitete rekreative sportive

Zëri i fëmijëve pothuajse nuk është shumë i dëgjueshëm sa ne kemi dëshirë dhe krijimi i një mekanizmi apo forme përmes së cilës zëri i fëmijëve do të jetë më i dëgjueshëm, do të krijoj praktika të mira të gjithëpërfshirjes të fëmijëve në vendimmarrjen dhe interesat e fëmijëve do të jenë prioritet për institucionet lokale.

Pjesëmarrja e fëmijëve duhet të jetë më gjithëpërfshirëse dhe shumë dimensionale karshi interesave të fëmijëve dhe palëve tjera me interes. Institucionet lokale do të konsultojnë fëmijët për çështje të ndryshme që lidhen me vendimmarrjen, që preken të drejtat e fëmijëve. Kjo do të bëhet duke fuqizuar organizatat e fëmijëve nëpër shkolla, Asamblenë Komunale të Fëmijëve, kulturën demokratike në shkolla, promovimin e sportit, kulturës dhe artit të cilat do ti shtyjë përpara DKRS.

2.1. Zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijët me rastin e vendimmarrjes

Do të hartohet një udhëzues praktik për procedurat e konsultimit të fëmijëve në të cilin do të parashihen fushat për të cilat do të konsultohen fëmijët. Ky proces do të zhvillohet në koordinim me të gjitha palët me qëllim të përfshirjes së fëmijëve në faza të hershme të konsultimit që i paraprijnë vendimmarrjes komunale. Po ashtu do të krijohet një ekip për të monitoruar procesin e konsultimit të fëmijëve.

2.2. Fuqizimi i organizatave të fëmijëve nga niveli shkollor e deri të Asambleja Komunale e Fëmijëve

Organizatave të fëmijëve në nivel shkolla janë të një rendësie të veçantë për të përfaqësuar interesat e fëmijëve në nivel të shkollës. Këto interesa duhet të promovojnë të drejtat dhe përgjegjësit e fëmijëve në nivel shkollor. Të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijëve duhet të promovohen përmes manualeve të veçanta të cilat promovojnë vlerat demokratike të shkollave përmes së cilave bëhet zgjedhja ose përfaqësimi në këshillin e nxënësve si dhe nderlidhja e tyre me Asamblenë Komunale të Fëmijëve.

2.3. Promovimi i kulturës demokratike në shkolla

Shkollat duhet të promovojnë kulturën demokratike në raport me fëmijët, përmes kësaj forme fëmijët mësojnë për demokracinë dhe ju krijohet hapësirë e mjaftueshme që të ndërmarrin nisma të ndryshme. Promovimi i vlerave demokratike është përkrahja e nxënësve në realizimin e projekteve të tyre të cilat janë në dobi të nxënësve dhe shkollës.

2.4. Promovimi i sportit nëpër shkolla dhe përmirësimi i infrastrukturës sportive

Drejtoritë përkatëse, në bashkëpunim me shkollat duhet të ndërmarrin hapa për promovimin e sportit shkollorë, inkurajimin e shkollave për themelimin e klubeve sportive shkollore aty ku nuk janë aktive si dhe organizimin e garave sportive në mes të shkollave të cilat përveq karakterit garues luajnë një rol të rëndësishëm edhe në socializimin e tyre.

2.5. Funksionalizimi i klubeve sportive të kategorive të reja

Institucionet shkollore dhe klubeve sportive duhet të rrisin bashkëpunimin e tyre në nivel institucional që të identifikojnë talentët e rinj në disiplina të ndryshme sportive qoftë edhe përmes organizimit të kampeve sportive.

Drejtoria përkatëse inkurajon dhe mbështet shkollat dhe klubet sportive për përfshirje të këtyre talenteve në klubet sportive.

2.6. Promovimi i artit dhe kulturës

Përmes promovimit të artit dhe kulturës në institucionet arsimore fëmijët do të dëmonstrojnë shkathtësitë e tyre në vlera kulturore dhe artistike. Shkollat së paku një herë në vit organizojnë aktivitete kulturore-artistike të cilat i shërbejnë fëmijëve të demonstrojnë shkathtësitë e tyre në art e kulturë. Promovimi i këtyre vlerave duhet të jetë me rëndësi jetike për shkollën dhe fëmijët sepse tek fëmijët do të krijoj mundësi të mira garimi mes bashkëmoshatarëve dhe shkëmbim përvojash.

2.7. Ofrimi i hapësirave joformale për rekreacion

Institucionet komunale duhet të ofrojnë hapësira të nevojshme për rekreacion për fëmijët gjatë kohës së tyre të lirë. Me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së fëmijëve në aktivitete rekreative, institucionet komunale do të bëjnë një vlerësim të mirëmbajtjes dhe funksionalizimit të hapësirave ekzistuese për rekreacion dhe krijimin e hapësirave të reja.

3. Krijimi i sistemit efektiv të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve

Mirëqenia e fëmijëve është jetike për institucionet komunale të Komunës së _____. Bashkëpunimi ndër-institucional dhe me partner të ndryshëm që merren me fëmijët dhe të drejtat e tyre do ta krijojnë një sistem efektiv në vetëdijesimin, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe përmirësimin e mirëqenies së tyre. Përmes fushatave të ndryshme avokuese do të ndermirren masa në vetëdijesimin e qytetarëve dhe akterëve të tjerë për një kujdes më të shtuar në raport me fëmijët. Lidhur me këtë mediat elektronike dhe të shkruara duhet të luajnë një rol kyq në paraqitjen e drejtë dhe informimit sa më të gjërë për punën dhe kujdesin në raport me fëmijët.

3.1. Trajnimet e zyrtarëve komunalë për aspekte të të drejtave të fëmijës dhe buxhetimit për fëmijë

Institucionet lokale duhet të luajnë rol të vazhdueshëm dhe proaktiv që të jenë në hap me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Për këtë arsye inkurajohen zyrtarët komunal për të ndjekur trajnime përmes së cilave sigurojnë që fëmijët të kenë trajtimin e duhur insitucional dhe shërbime e kujdes më cilësore ndaj tyre. Njëherit zyrtarët Komunal gjatë fazës së hartimit të buxhetit komunal duhet të planifikojnë buxhet për aktivitetet të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejta të fëmijëve.

3.2. Fushatat vetëdijesuese për të rriturit e fëmijët si dhe avokim i pavarur për fëmijë

Komuna mike për fëmijë ofron një qasje multidisiplinare për tërsinë e shërbimeve që ofron, të cilat promovohen përmes fushatave, ligjeratave publike si dhe materialeve të ndryshme promovuese për ngritjen e vetëdijesimit për të rriturit e fëmijët. Po ashtu organizatat e shoqërisë civile, koalicionet e ndryshme mund të ndermarin nisma apo programe të ndryshme vetëdijesuese të cilat avokojnë tek insitucionet lokale për një qasje të drejtë në raport me të drejtat e fëmijëve.

3.3. Puna me mediat dhe profesionistët e mediave lokale

Mediat luajnë një rol të rëndësishëm në paraqitjen e punës së insitucioneve komunale me theks të veçantë në aktivitetet që kanë të bëjnë me të drjtat e fëmijëve. Për ta bërë këtë, mediat duhet të jenë profesionale dhe të mbajnë të dukshme lajmet për të drejtat e fëmijës në komunë. Për të ruajtur konfidencialitetin dhe integritetin e fëmijëve komuna harton udhëzues në bashkëpunim me profesionistët e mediave, se si mediat lokale të kenë qasje ndaj fëmijëve gjatë raportimeve të tyre. Në kuadër të kësaj insitucionet komunale mund të organizojnë forume të ndryshme diskutimi me tematikë mbi standardet për mbrojtjen e identitetit dhe integritetit të fëmijëve.

4. Krijimi i hapësirave publike të sigurta dhe promovimi i mjedisit ekologjik

Komuna mike për fëmijë synon të krijoj hapësira të sigurta publike dhe mjedis ekologjik për fëmijët përmes së cilave krijohet ndjenja e sigurisë në çdo kohë e vend. Kjo nënkupton që insitucionet komunale gjatë përgatitjes së planeve urbanistike me qëllim të shmangjes së rreziqeve në hapësirat publike të konsultojnë fëmijët dhe prindërit.

4.1. Eliminimi i rreziqeve dhe krijimi i mjedisit ekologjik

Hapësirat publike potencialisht paraqesin rrezik për fëmijët për shkak të ndotjeve të vazhdueshme dhe mos mirëmbajtja së tyre. Ekspozimi sistematik i fëmijëve në këto hapsira publike mund të paraqes rrezik potencial në sëmundje dhe infeksione të ndryshme. Përkujdesi insitucional duhet të jetë i vazhdueshëm në eliminimin e këtyre rreziqeve me qëllim që për shkak të neglizhencës së bartësve të shërbimeve publike, si dhe për shkak të personave të pandërgjegjshëm që dëmtojnë pronën publike të mos pësojnë fëmijët.

Komuna e _____ ndërmerr masa në shtrirjen e grumbullimit të mbledhjes së mbeturinave në hapësira publike dhe në të gjitha lokalitete e Komunës, po ashtu do të krijoj një sistem efikas të raportimit për rastet e dëmtimeve të hapsirave publike.

4.2. Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët

Institucionet lokale duhet të vlerësojnë shkallën e rrezikshmërisë në trafik në të gjitha lokalitet e komunës së _____ me theks të veçantë në afërsi të insitucioneve arsimore. Ofrimi i vendkalimeve të sigurta do të eliminojë rreziqet për ato shkolla që janë në afërsi të rrugëve më të frekuentuara dhe rrugëve kryesore.

Institucionet lokale duhet të krijojnë një plan operative me të cilin do të bëjnë lirim e hapësirave publike, shënjimin e vendkalimeve, lirim e trotuareve, shtigjet për personat me nevoja të veçanta. Për të gjitha këto duhet të bëhet një fushatë informuese për pjesëmarrësit në trafik.

5. Bashkërendimi i veprimeve të të gjithë akterëve përmes procesit të koordinimit, si dhe përmes vlerësimit dhe raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë

Ne duam që i gjithë procesi i krijimit të komunës mike për fëmijë të ketë pronësi të gjerë, ku të gjitha palët do të bashkërendojnë veprimet me qëllimin që të adresohen masat e definuara me strategjinë dhe planin e veprimit. Një koordinim efikas është i nevojshëm për të siguruar këtë bashkërendim të veprimeve dhe po ashtu një komunikim i hapur. Ndërsa, për të siguruar cilësinë na nevojitet një vlerësim periodik i ndikimit të veprimeve për fëmijë, si dhe një raportim për gjendjen e fëmijëve të komunës.

5.1. Krijimi i mekanizmit koordinues në nivel komunal

Fëmijët duhet të bëhen të dukshëm në politikat qeverisëse. Për të bërë këtë, do të krijohet mekanizmit koordinues në nivel komune. Ky mekanizmi koordinues do të udhëhiqet/kryesohet nga Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale siç është përcaktuar në Rregulloren për realizimin dhe mbrojtjen e të drjtave të fëmijëve Komuna, me aktin e themelimit të mekanizmit koordinues përcakton përbërjen, fushëveprimin dhe procedurat e funksionimit.

5.2. Krijimi i një sistemi të menaxhimit të informatave jo konfidenciale për fëmijët

Për të pasur një pasqyrë të saktë të gjendjes së fëmijëve të komunës dhe për të përcaktuar si duhet nevojat për intervenime, është e domosdoshme të ekzistojë një sistem i besueshëm i menaxhimit të informatave jo konfidenciale për fëmijët. Sisteme të tilla sektorale si në arsim, shëndetësi, fëmijë në konflikt me ligjin, ekzistojnë ose janë në proces të funksionalizimit në nivelin qendror, andaj shtrohet nevoja që në nivel lokal të krijohet një sistem me të dhëna jo konfidenciale për fëmijët.

5.3. Vlerësimi i ndikimit në fëmijë dhe raportimi për gjendjen e fëmijëve

Komuna mike për fëmijë ka nevojë t'i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit që ka në fëmijë. Tashmë, gjatë procesit të planifikimit të strategjisë dhe planit të veprimit, një vlerësim i tillë është bërë, duke e përdorur një mjet vetvlerësimi që është i mbështetur në standardet e krijimit të komunës mike për fëmijë. Megjithatë, ne do ta mbajmë të rregullt vlerësimin e ndikimit aktual në fëmijët, të aspekteve të qeverisjes lokale dhe aspekteve të strategjisë për komunën mike për fëmijët. Secila njësi komunale, por edhe organizatat dhe institucionet e pavarura do ta bëjnë këtë vlerësim dhe do të dalin me rekomandime për përmirësime. Të gjitha këto vlerësime do të përmbliken në raporte periodike për gjendjen e fëmijëve. Të gjeturat e raporteve do të diskutohen në nivel të mekanizmit koordinues dhe do të referohen edhe te autoritetet më të larta qeverisëse komunale.

5.4. Koordinimi me palët relevante

Qasja e bashkëpunimit me të gjitha palët, është parim i punës së qeverisjes komunale në përpjekjen për një komunë mike për fëmijë. Do të mbajmë të vazhdueshëm komunikimin dhe bashkëpunimin me organizata, grupe joformale, bashkësi lokale, këshilla, etj. Bashkarisht do të identifikojmë çështje të implementimit të masave dhe gjetje të mënyrave me efektive. Po ashtu, do të koordinohemi me institucionet qendrore/rajonale që ofrojnë shërbime në nivel komunal, por edhe me vet qeverisjen qendrore që të sigurojmë politika të mira për fëmijët, si dhe të kërkojmë përkrahje shtesë nga niveli qendror për nevojat e fëmijëve të komunës.

5.5. Vlerësimi i ndërmjetëm dhe përfundimtar i zbatimit të strategjisë

Cilësia e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit do të vlerësohet në mes të periudhës zbatuese (vlerësimi i ndërmjetëm) dhe në fund të periudhës zbatuese (vlerësimi përfundimtar). Nga këto vlerësime do të dalin raporte që do të informojnë masat për përmirësim të zbatimit, respektivisht për planifikim të strategjisë së re.

5.6. Cikli i ri strategjik

Disa muaj para se të përmbillet zbatimi i strategjisë ekzistuese, ne do të mobilizohemi në planifikimin e ciklit të ri strategjik. Ky planifikim do të ketë për bazë përvojat me realizimin e strategjisë ekzistuese dhe rrethanat aktuale lidhur me gjendjen e fëmijëve të komunës.

PLANI I VEPRIMIT

	Objektiva strategjike
	Masa
	Veprimet
1.	Ofrimi i shërbimeve cilësore për të gjithë fëmijët e Komunës, me fokus të veçantë në kategoritë e fëmijeve në nevojë
1.1.	Krijimi i një sistemi informues përmes zyrës për informim për tërsinë e shërbimeve për fëmijë në Komunë
	Analizohet situata e shërbimeve ndaj fëmijëve në Komunë
	Zhvillohet katalogu i ofruesve të shërbimeve, bëhet listimi i llojeve të shërbimeve sociale dhe organizohen fushata informuese nga institucionet lokale dhe shoqëria civile
1.2.	Ofrimi i financimit emergjent për fëmijë
	Krijohet një fond operativ nga Komuna për QPS në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për fëmijët (para e imët)
1.3.	Fuqizimi i konceptit të familjeve strehuese dhe farefisnore përmes subvencionimit nga Qendra për Punë Sociale
	Organizohet një fushatë informuese për publikun për rolin e familjes strehuese dhe farefisnore
	Bëhet identifikimi dhe vlerësimi i familjeve strehuese dhe farefisnore
	Shkëmbehen praktikatat e mira dhe trajnohen familjet strehuese dhe farefisnore
	Subvencionimi për familjet strehuese dhe farefisnore
1.4.	Përkrahje në ekzekutimin e masave të diversitetit, masave edukative dhe dënimeve për fëmijë që kanë rënë ndesh me ligjin
	Nënshkruhet një memorandum i mirëkuptimit në mes të Komunës, Shërbimit Sprovues të Kosovës (SHSK) dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës
	Institucionet komunale sipas nevojave të tyre për shërbim në komunitet i pranojnë rastet që referohen nga SHSK
	Krijohet komunikim i rregullt në mes të komunës dhe Shërbimit Sprovues të Kosovës, për adresimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin
	Komuna konform obligimeve të marra nga niveli qendrorë i adreson çështjet që ndërlidhen më arsimin e fëmijëve që janë me masa edukative dhe dënime
1.5.	Zhvillimi i praktikave të prindësisë së mirë dhe promovimi shëndetësor
	Krijohen kapacitetet njerëzore për ofrimin e moduleve të trajnimit (trajnim i trajnerëve)
	Ndërmerret fushatë vetëdijesuese për shëndetin dhe të ushqyerit e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve
	Shpërndahen praktikatat e prindësisë së mirë përmes trajnimeve dhe fushatave vetëdijesuese (rreth ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve)
1.6.	Rritja e përfshirjes së fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në shërbimet/programet për edukim dhe zhvillim në fëmijëri të hershme
	Vlerësohen nevojat komunale për edukim dhe zhvillim në fëmijërinë e hershme

	Ftohet sektori privat për shprehje të interesit për partneritet me komunën në fushën e edukimit parashkollor
1.7.	Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët për t'u regjistruar në shkollë, për ta vijuar dhe për përfunduar atë
	Bashkëpunohet me zyrën e regjistrimit civil dhe merren informata për të gjithë fëmijët e moshës shkollore të zonës
	Regjistrohen nxënësit duke respektuar rregulloren e komunës për rajonalizimin e shkollave
	Mirëmbahet baza e të dhënave me të dhëna për nxënësit sipas modelit të SMIA-s
	Funksionalizohen Ekipe për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mos regjistrimit (EPRBM)
	Bashkëpunohet ngushtë me organizatat që punojnë në fushën e gjithë përfshirjes në arsim
1.8.	Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër shkolla
	Shtohen resurset njerëzore në DKA për ngritje të kapaciteteve, zhvillim profesional të mësimit dhe sigurim të cilësisë
	Trajnohen mësimit për identifikimin e hershëm të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale pedagogjike, psikologjike, sociale dhe të shëndetit mendor
	Krijohet mekanizmi për referimin e fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale
	Hartohet dhe zbatohet plani i intervenimit profesional shëndetësor
	Identifikohen nevojat për mësimit mbështetës për fëmijët me nevoja të veçanta
	Përfshihen fëmijët në vendimmarrjen e shkollave
1.9.	Hartëzimi i hapësirave shkollore për sigurimin e arsimit cilësor
	Krijohen ekipe profesionale për inspektim të gjendjes së shkollave (inspektim të vjetërsisë së objekteve, sanitarisë, hapësirave për lojë e rekreacion, pajisjeve shkollore, etj)
	Inspektohen objektet shkollore në baza vjetore dhe hartohen raporte
	Ndërmerren masa për të përmirësuar gjendjen e shkollave bazuar në raportet e inspektimit
	Promovohen standardet për shkollat mike për fëmijë
	Ndërmerren hapa për ofrimin e sigurisë në shkolla
1.10.	Krijimi i mekanizmave brenda shkollave për mirëmbajtje të objekteve (mjediseve) shkollore
	Vetëdjeheshen nxënësit dhe palët tjera për nevojën e mirëmbajtjes së shkollës
	Hartohet një udhëzues me shembuj praktik për mirëmbajtjen e hapësirave shkollore
	Krijohen ekipe shkollore për koordinimin e veprimeve të mirëmbajtjes së hapësirave shkollore
	Ndahet çmimi vjetor për komunitetin më të vjeshëm shkollor
1.11.	Organizimi i vizitave multidisiplinare shëndetësore dhe sociale të obligueshme për fëmijët, në baza periodike
	Hartohet udhërrëfyesi për shërbimet e vizitave në shtëpi për grupet e varfra dhe të marginalizuara
	Organizohet shërbimi i vizitave sistematike nëpër shtëpi, që do të kenë përveç komponentit të intervenimit shëndetësor edhe atë edukativ
	Zbatohen praktikat efektive të kujdesit perinatal dhe paliativ
	Përfshihen të gjithë fëmijët në shërbimin e vaksinimit

1.2.	Identifikimi i hershëm lidhur me gjëndjen shëndetësore dhe emocionale të fëmijës
	Zhvillohet dokumenti për deklarin e prindit për gjendjen shëndetësore të fëmijës, si parakusht për regjistrim në shkollë
1.3.	Ofrohen shërbime të veçanta për kategoritë e fëmijëve në nevojë
	Komuna përmes QPS identifikon dhe krijon një databazë për fëmijët me nevoja të veçanta
	Ofrohen shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim i bazuar në bashkësi, për fëmijët me aftësi të kufizuar
	Sigurohet qasja fizike e fëmijëve me aftësi të kufizuara në hapësira publike
	Sigurohet një qendër ditore për ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse për fëmijët në nevojë
	Ofrohen shërbime cilësore për fëmijët viktimë të dhunës në familje bashkë me nënat e tyre të strehuar dhe shërbimeve tjera sociale
	Ofrohen programe të mbështetjes shtesë për fëmijët në nevojë/grupeve të marginalizuar
	Organizohet fushatë shumëdimensionale për parandalimin e punëve të rënda për fëmijë
2.	Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse në Komunë dhe aktivitete rekreative sportive
2.1.	Zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijët me rastin e vendimmarrjes
	Hartohet një udhëzues praktik për procedurat e konsultimit me fëmijë
	Nxjerrët një vendim komunal për konsultimin e fëmijëve në faza të hershme të proceseve që i paraprijnë vendimmarrjes
	Krijohet një ekip për të monitoruar zbatimin e procedurave të konsultimit me fëmijë
2.2.	Fuqizimi i organizatave të fëmijëve nga niveli shkollor e deri të Asambleja Komunale e Fëmijëve
	Themelohen/funksionalizohen organet përfaqësuese të nxënësve në të gjitha nivelet, duke filluar nga këshillat e nxënësve nëpër klasë, e deri te Asambleja Komunale e Fëmijëve
	Shfrytëzohen manualët ekzistues, ose të hartohet manual i veçantë për operimin e organizatave të fëmijëve
	Përkrahen fëmijët në ushtrimin e demokracisë, përmes zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre, prindërve e mësuesve, si dhe programeve trajnuese e këshilluese
	Promovohet ndërmjetësimi në mes moshatarëve si qasje për të adresuar problemet, konfliktet, ngacmimet e dhunën në shkollë, por edhe në lagje
2.3.	Promovimi i kulturës demokratike në shkolla
	Zhvillohen kapacitetet e të gjitha palëve në shkollë për të ushqyer kulturën demokratike në shkollë
	Përkrahen shkollat në realizimin e projekteve të qytetarisë demokratike në shkollë dhe komunitet, ku do të përfshihen nxënësit, si dhe komuniteti i shkollës dhe partnerët tjerë
2.4.	Promovimi i sportit nëpër shkolla dhe përmirësimi i infrastrukturës sportive
	Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport në bashkëpunim me shkollat organizon promovimin e sportit shkollorë
	Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport inkurajon shkollat të themelojnë klubet sportive shkollore aty ku nuk janë aktive
	Organizohet gara sportive në mes të shkollave

2.5.	Funksionalizimi i klubeve sportive të kategorive të reja
	Inkurajohen klubet sportive për përfshirje të fëmijë (djem dhe vajza) në klubet sportive
	Inkurajimi dhe mbështetja e shkollave sportive me qëllim të përfshirjes së fëmijëve nga të gjitha komunitetet në aktivitete sportive
	Drejtoria për Kulture Rini dhe Sport mbështetet komunikimi në mes të klubeve, shkollave dhe prindërve
	Drejtoria për Kulture Rini dhe Sport mbështet klubet sportive në organizimin e kampeve për identifikimin e talentëve në sporte
2.6.	Promovimi i artit dhe kulturës
	Shkollat promovojnë artin dhe kulturën përmes krijimit të trupave artistike e kulturore të shkollave
	Shkollat së paku një herë në vit organizojnë aktivitete kulturore-artistike
	Shkollat të krijojnë hapësirat e nevojshme për organizimin e aktiviteteve të ndryshme përfshirë edhe ekspozita,
	Të shikohet mundësia e përfshirjes së Drejtoria për Kulture Rini dhe Sport në organizim të aktivitete garuese në art dhe kulture
2.7.	Ofrimi i hapësirave joformale për rekreacion
	Të vlerësohen hapësirat ekzistuese jo-formale për rekreacion, mirëmbajtja dhe funksionalizimi i tyre
	Të mundësohet krijimi i hapësirave të reja rekreative në të gjithë Komunën
3.	Krijimi i sistemit efektiv të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve
3.1.	Trajnimet e zyrtarëve komunalë për aspekte të të drejtave të fëmijës dhe buxhetimit për fëmijë
	Komuna organizon apo inkurajon zyrtarët komunal për pjesëmarrje në trajnime në fushën e të drejtave të fëmijëve
	Zyrtarët Komunal gjatë fazës së hartimit të buxhetit komunal planifikojnë buxhet për aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve
3.2.	Fushatat vetëdijesuese për të rriturit e fëmijët si dhe avokim i pavarur për fëmijë
	Organizohet fushata vetëdijesuese për të rriturit dhe fëmijët
	Organizohen ligjërata publike dhe shpërndahet material promovues për komunën mike për fëmijë
	Ofrohen programe për të drejtat e njeriut dhe qytetarinë demokratike për fëmijët përmes edukimit joformal
	Përkrahet puna e organizatave joqeveritare, koalicioneve e rrjeteve që monitorojnë, promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijës
	Mundësohet dhe përkrahet puna e vet organizatave të fëmijëve dhe të rinjve
	Përkrahet procesi i avokimit të organet e nivelit lokal dhe qendror
3.3.	Puna me mediat dhe profesionistët e mediave lokale
	Komuna ofron udhëzues dhe trajnime për zyrën komunale për marrëdhënie me publikun dhe mediat e profesionistët e mediave të shkruara dhe elektronike
	Mbështeten mediat dhe profesionistët e mediave që të mbajnë të dukshme lajmet për të drejtat e fëmijës në komunë

	Me iniciativë të Komunës organizohen forume diskutimi në mes të komunës dhe mediave lidhur me standardet për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe integritetit të fëmijëve
4.	Krijimi i hapësirave publike të sigurta dhe promovimi i mjedisit ekologjik
4.1.	Eliminimi i rreziqeve dhe krijimi i mjedisit ekologjik
	Identifikohen lagjet pa sistem të ujit të pijes e menaxhimit të ujërave të zeza dhe hartohen projekte për intervenim
	Të shtrihet grumbullimi i mbledhjes së mbeturinave në hapësira publike dhe në të gjitha lokalitete e Komunës
	Krijohet një sistem efikas i monitorimit të hapësirave publike duke siguruar mjedis ekologjik
	Të krijohen mekanizma për raportim për rastet e dëmtimeve të hapësirave publike
	Komuna të ndër marr veprime të rritjes së hapësirave të gjelbra publike
4.1.	Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët
	Hartohen dhe realizohen projekte për lirim të trotuareve dhe vendkalimeve për këmbësorë, në veçanti afër objekteve shkollore përfshirë shënjimin e vendkalimeve
	Hartohet dhe realizohet projekti për shtigjet për personat me nevoja të veçanta dhe parkingjet e biçikletave
	Bëhet fushatë informimi më të gjithë pjesëmarrësit në trafik për sigurinë në trafik
	Sigurohet transporti falas për nxënës me nevoja të veçanta
5.	Bashkërendimi i veprimeve të të gjithë akterëve përmes procesit të koordinimit, si dhe përmes vlerësimit dhe raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë
5.1.	Krijimi i mekanizmit koordinues në nivel komunal
	Përcaktohet fushëveprimi i mekanizmit koordinues dhe procedurat e funksionimit
	Merret vendimi për themelimin e mekanizmit koordinues
	Krijohet sekretariati i mekanizmit koordinues
5.2.	Krijimi i një sistemi të menaxhimit të informatave jo konfidenciale për fëmijët
	Organizohet punëtori për identifikimin e termave të referencës për sistemin e menaxhimit të informatave jo konfidenciale për fëmijët
	Trajnohen përgjegjësit për mënyrën e përdorimit të sistemit të menaxhimit të informative
5.3.	Vlerësimi i ndikimit në fëmijë dhe raportimi për gjendjen e fëmijëve
	Bëhet vlerësimi periodik i ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale dhe aspekteve të strategjisë për komunën mike për fëmijë
	Përmbledhen rezultatet e vlerësimit në raporte përmbledhëse që përfshijnë edhe rekomandimet për përmirësim
	Diskutohen raportet në nivel të mekanizmit koordinues dhe po ashtu referohen te autoritetet më të larta të qeverisjes komunale
5.4.	Koordinimi me palët relevante
	Mbahet komunikim e bashkëpunim i vazhdueshëm me organizata, grupe joformale, bashkësi lokale, këshilla, etj.
	Koordinohet puna me institucionet qendrore që ofrojnë shërbime në nivel komunal

	Bashkëpunohet me nivelin qendror të qeverisjes për të siguruar politika të mira për fëmijët dhe fonde shtesë për nevojat e fëmijëve të komunës
5.5.	Vlerësimi i ndërmjetëm dhe përfundimtar i zbatimit të strategjisë
	Bëhet vlerësimi i ndërmjetëm i zbatimit të strategjisë dhe hartimi i raportit të ndërmjetëm
	Bëhet vlerësimi përfundimtar i zbatimit të strategjisë dhe hartimi i raportit përfundimtar
5.6.	Cikli i ri strategjik
	Shqyrtohen vlerësimet dhe raportet për të informuar planifikimin e ciklit të ri strategjik
	Planifikohet strategjia e re dhe plani i saj i veprimit



European
Union
Kosovo